



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0980**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Interlab” SH.P.K, kundër Njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” me numër të prokurimit 206-23-11488-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 15/02/2024, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE “Interlab” SH.P.K. me nr. 2023/0980, e datës 04/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së”, me numër të prokurimit 206-23-11488-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
2. Mbetët në fuqi vendimi i AK-së për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit të cituar si në pikën I të dispozitivit.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 24.10.2023 Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së”, me numër të prokurimit 206-23-11488-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: LOT 1: 888, 201. 00 €.

Me 14.11.2023 "Interlab" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Interlab" SH.P.K me nr. 980/23 lidhur me aktivitetin "Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së", me numër të prokurimit 206-23-11488-1-1-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues "InterLab":* Duke e pasur parasysh se Kërkesa juaj për Rishqyrtim ka atakuar Specifikacionin Teknik të Dosjes së Tenderit, si e tillë është trajtuar nga Njësia Kërkuese, konkretisht nga profesionistët biomjeksor dhe profesionistët shëndetësor.

1. Përgjigjeje ne pretendimin numër 1-është standard të të gjithë llojet e mikroskopëve dhe nuk është vetëm për mikroskopin që OE (Operatori Ekonomik) I referohet, prandaj kjo është e hapur që çdo OE mundet të ofertoj me produktet e tyre. Note: Sistemi i Laserit duhet të jetë No Calibration dhe këtë nuk e ofron vetëm një prodhues!

2. Përgjigjeje ne pretendimin numër 2 - është standard të të gjithë llojet e mikroskopëve dhe nuk është vetëm për mikroskopin që OE i referohet, prandaj kjo është e hapur që çdo OE mundet të ofertoj me produktet e tyre.

Ne lidhje me pretendimet numër 3 dhe 4 - nuk qëndrojnë këto pretendime, Secili OE që oferton pajisjet e teknologjisë së fundit në fushën e Frytnimit të Asistuar Mjekësor (FAM) është i lirë që ti ofroj produktet e veta të cilat kanë performancë Ekuivalente apo edhe më të avancuar në krahasim me specifikat teknike të kërkuara. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

*Pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues OE "InterLab" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:*

*Ankuesi pretendon se:* "Njësia e kërkesës- Shkel Nenin 7 dhe 28 të LPP-se (Specifikime teknike favorizuese) Përpilimi i specifikimeve teknike të detyrueshme nga njësia e kërkesës për llot 1 artikujt: 1. Inverted Microscope for ICSI/IMSI with micromanipulator and laser 2. Inverted Microscope for ICSI with micromanipulator 3. Contrast binocular phase microscope with LWD 20x objective 4. Stereo Microscope të cilët i janë përshtatur pike për pike vetëm prodhuesit Zeiss dhe laserit octax navilase duke përmendur edhe emrat e objektivave të cilët janë të krijuar dhe prodhuar vetëm nga ky prodhues si psh për produktin numër 1 tek specifikimet teknike janë disa

pika qe i perkasin vetem Zeiss: Minimum objective lens focal length 190mm: 5X/0.12 eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss dhe AK per ketë pike nuk na ka kthyer fare pergjigje pra i kanë devijuar si pike.

- BNK module eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss
- Condenser for micromanipulation, minimum working distance, minimum numerical aperture 0.50 eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss. Tek specifikimi teknik i laserit specifikimet janë te pershtatura per produktin OCTAX NaviLase
- No calibration eshte specifikim qe te drejton vetem tek ky produkt (OCTAX NaviLase)
- Different dynamic laser modes available: zone drilling, zone thinning, trophectoderm biopsy eshte specifikim qe te drejton vetem tek ky produkt (OCTAX NaviLase). Per produktin numër 2 tek specifikimet teknike janë disa pika qe i perkasin vetem Zeiss: Minimum objective lens focal length 190mm: 5X/0.12; eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss
- BNK module eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss Condenser for micromanipulation, minimum working distance 400mm, minimum numerical aperture 0.50 eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss. Per produktin numër 3 tek specifikimet teknike janë disa pika qe i perkasin vetem Zeiss: Ergonomic adjustable focus knob eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss.
- X/Y stage control, rubber surface, removable rubber cover eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss. Color coded capacitor 0.90 / 1.25 oil PH, DF eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss. Per produktin numër 4 tek specifikimet teknike janë disa pika qe i perkasin vetem Zeiss:
- 16x/15B eyepiece. eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss.
- 45 degree inclined binocular tube eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss.
- Minimum working distance of 90 mm eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss. Minimum resolution 305 lp/mm eshte specifikim teknik qe i perket vetem zeiss. Kjo bie ndesh me Nenin 28 Paragrafi 2 te LPP-se “Autoriteti kontraktues do t’i perpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues eshte veçanerisht i ndaluar që të hartojë specifikimet teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Gjithashtu ky përpilim teknike nga njësia e kërkesës eshte diskriminues për te gjitha prodhues tjerë sepse nuk kane mundësi konkurrimi ne raport me kushte teknike te konkurrencës/trajtim i barabarte, andaj kjo bie ndesh me RrUOPP, Neni 20 Paragrafi 3” Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit” dhe paragrafi 4 te këtij Neni “Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara. Gjithashtu bie ndesh me parimin e direktivës se Bashkimit Evropian qe eshte citat ne RrUOPP, Neni 20. Si pale me interes material për te paraqitur ofertë për ketë

aktivitet te prokurimit kërkojmë nga njësia e kërkesës te modifikoj specifikimet teknike te detyrueshme për llot 1 për pjese e specifikimeve qe i potencuam qe janë specifikime qe te drejtojnë vetëm tek produktet e zeiss për artikujt 1, 2, 3, 4, ne mënyre qe te mundësohet konkurrenca ne mes prodhueseve për produktet qe ju kërkon/nevojat minimale teknike te konkurrencës, pasi qe kjo është procedure e hapur dhe qëllimi i Autoritetit kontraktues sipas LPP-se është trajtimi i barabarte i OE dhe prodhueseve pjesëmarrës për te arritur qëllimin-Parimin e Ekonomicitetit. Andaj kjo arrihet vetëm kur termat teknike te jene minimal qe përfshijnë disa prodhues ne treg qe te mundësoj konkurrenca maksimale ne mes Operatoreve ekonomik dhe jo kur paraprakisht si ne rastin ne fjalë te dihet se cilin prodhues dhe produkt. Me këtë lloj kufizimi te pjesëmarrjes ne këtë aktivitet te prokurimit publik, fituesi është tanimë i paracaktuar te cilit i mundësohet keqpërdorimi i buxhetit te Republikës se Kosovës për mbi 580,000.00 euro duke u bazuar ne çmimet e tregut dhe top bendet si: Nikon dhe Olympus te cilët janë shume me te specializuar ne fushën e IVF.

*-Administrimi dhe vlerësimi i provave-*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 07.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 980/23, ndërsa me datë 22.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0980 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik/shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar ndërkaq vendimi i AK-së të mbetet në fuqi”.

*Lidhur me pretendimet e “InterLab” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0980 ka vlerësuar si në vijim:*

*Sqarim hyrës:* Aktiviteti i prokurimit: “Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësit organizative te QKUK-se” me nr. të prokurimit: "206-23-11488-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, ka filluar me njoftimin për kontratë me datë 24.10.2023, për të cilin njoftim brenda afatit ligjor OE ankuesi parashtroi kërkesë rishqyrtim pranë AK-së, mirëpo pas refuzimit të kërkesës, atëherë me datë 06.12.2023 i njëjti parashtroi ankesë në OSHP, duke pretenduar se AK kriteret në njoftimin për kontratë, përkatësisht LOT 1 specifikimet teknike, janë diskriminuese dhe subjektive. OE ankuesi pretendon: Njësia e kërkesës- Shkel Nenin 7 dhe 28 te LPP-se (Specifikime teknike favorizuese) Përpilimi i specifikimeve teknike te detyrueshme nga njësia e kërkesës për llot 1 artikujt: 1. Inverted Microscope for ICSI/IMSI with micromanipulator and laser 2. Inverted Microscope for ICSI with micromanipulator 3. Contrast binocular phase microscope with LWD 20x objective 4. Stereo Microscope i njëjti konsideron se AK i ka përshtatur specifikat për prodhuesin Zeiss dhe laserit Ocatax.

Ekspertja teknike pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, për produktet Lot 1: 1. Inverted Microscope for ICSI/IMSI with micromanipulator and laser 2. Inverted Microscope for ICSI with micromanipulator Ne këtë dy pika AK ka përzgjedhur pajisjet qe përdorin teknikat me te avancuara te cilat janë nga metodologjitë me te reja për In Vitro Fertilization (IVF), Intracytoplasmic Sperm Injection (ICSI) and Intracytoplasmic Morphologically-Selected Sperm Injection (IMSI) dhe te cilat janë pjese esenciale e secilit mikroskop. Moduli BNK integron kulturën e blastocistit dhe aftësitë e kariotipit në rrjedhën e punës IVF. Kombinimi i teknologjive të avancuara, duke përfshirë modulin BNK, kontribuon në nivele më të larta sukcesi në procedurat IVF. Moduli BNK rrit aftësitë e sistemit të këtij

mikroskopi, duke ofruar një qasje më të plotë dhe më të avancuar për përzgjedhjen e embrionit dhe shqyrtimin gjenetik në kontekstin e IVF. ( No Calibartion) Nevojat e reduktuara të kalibrimit kontribuojnë në një performancë më të besueshme dhe të parashikueshme, duke siguruar rezultate të qëndrueshme dhe të sakta në procedurat IVF, dhe minimizimi i kohës së shpenzuar për kalibrimin i lejon embriologët të përqendrohen në procedurat aktuale duke çuar në një rrjedhë pune më efikase dhe potencialisht duke rritur numrin e cikleve që mund të përpunohen, dhe në këto dy pika pretendimet ankimore të OE ankues janë të pabazuara. 3. Contrast binocular phase microscope with LWD 20x objective 4. Stereo Microscope Poashtu, në këto dy pika nuk qëndrojnë këto pretendime: Mikroskopi i fazës binokulare me kontrast ofron vizualizim të zgjeruar të ekzemplarëve transparentë ose me kontrast të ulët, gjë që është thelbësore për vëzhgimin e strukturave delikate në qelizat dhe indet riprodhuese gjatë IVF. Mikroskopi është projektuar posaçërisht për të përmbushur kërkesat unike të procedurave IVF, duke siguruar mjetet e nevojshme për vëzhgimin, manipulimin dhe mbrojtjen e saktë të mostrave delikate riprodhuese. Dhe poashtu, AK ka sqaruar që secili OE që oferton me pajisjet e teknologjisë së fundit në fushën e Frytnimit të Asistuar Mjekësor (FAM) është i lire që ti ofroj produktet që kanë performancë ekuivalente apo edhe më të sofistikuar të brendeve të njohura botërore, dhe në këto dy pika pretendimet e OE ankues janë të pabazuara. Andaj Eksperti shqyrtues/teknik, duke u bazuar në sqarimet e dhëna më lart, vlerësojnë se ankesa e OE ankues është e pa bazuar dhe vendimi i AK-se, të mbetet në fuqi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar me rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues/teknik, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues/teknik.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -*

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 11.07.2023, Kompania Rajonale Ujësjellësit Hidromorava Sh.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me kimikate (klor të gazet dhe të lëngët) dhe Permanganat Kaliumi” me nr. të prokurimit: "nuk ka-23-7113-1-2-1". Ndërsa me datën 21.11.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë GOE “Infinit Sh.P.K”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 93,960.00 €.

Me 27.11.2023, OE “Seykos SH.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 07.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 14.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Seykos Sh.P.K.” me nr. 1016/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me kimikate (klor të gazet dhe të lëngët) dhe Permanganat Kaliumi” me nr. të prokurimit: "nuk ka-23-7113-1-2-1".

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109

paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim:* OE "Seykos" SH.P.K e dt. 04.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Furnizim me kimikate (klor te gazet dhe te lëngët) dhe Permanganat Kaliumi? me Nr. te Prok: nuk ka-23-7113-1-2-1 dhe nr. te brendshëm KRU 23 018 121. Autoriteti Kontraktues me datën 07.12.2023 ka shqyrtuar kërkesat me fjale si me poshtë: Pas shqyrtimit dhe analizimit te kërkesës për rishqyrtim te parashtruar nga OE "SEYKOS" Sh.P.K. Autoriteti Kontraktues - KRU Hidromorava ka konstatuar se pretendimet e juaja janë te pa bazuara dhe mbetet ne fuqi vendimin i AK i dt. 21.11.2023 duke u bazuar ne vendimin e OSHP-së me nr. 2023/0662 te dt.20.10.2023, ku ky vendim thotë si më poshtë: Paneli vëren se arsyet e dhëna ne raportin e ekspertizës janë dhëne shpjegime te detajuar rreth përmbajtjes dhe vlerësimit te pretendimeve nga ana e ekspertit shqyrtues, pa nevojë qe te përshkruhen serish. Prandaj paneli mbështet shpjegimet dhe arsyetimet e ekspertit shqyrtues qe aktiviteti i prokurimit te kthehet ne ri-vlerësim dhe e mbështet vetëm arsyetimin e pretendimit me Nr. rendor I të radhitur ne raportin e ekspertizës dhe përket mund t'i kërkohen sqarime shtese konform nenit 72 te LPP, ndërsa sa i përket pohimit ankimore se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar specifikacion teknik për pozicionin nr.3 te paramases Pemanganat Kalium. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues ka deklaruar se mund te kërkohen informacione shtese konform udhëzuesit për prokurim publik. Por panelin shqyrtues ne ofertën e OE te rekomanduar për kontrate nuk ka hasur se ekzistojnë këto specifikime teknike andaj ky pretendim ishte i bazuar sepse sipas udhëzuesit te lartcekur ne nenin 10 thuhet se kur mungon specifikacioni teknik dhe katalogjet për produktet e ofruara atëherë tenderi duhet te refuzohet: Megjithatë, paneli shqyrtues për te qenë komplet te sigurt lidhur me ketë konstatim pasi qe specifikacionct teknike janë ne gjuhen angleze dhe panelit shqyrtues ka mundësi te ik ndonjë informacion, atëherë e obligon AK qe të beje një verifikim te dy katalogjeve tjera te ofruara për dy pozicionet, nëse eventualisht ka specifikacion teknik për pozicionin nr.3 te paramases Pemanganat Kalium, nëse po, atëherë te kërkohen informacione shtese, nëse jo të refuzohet tenderi pa kërkuar informacion shtese.”

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Seykos Sh.P.K", janë parashtruar si në vijim:*  
*Pretendimi i parë (I):* "1 1. Autoriteti Kontraktues, në këtë rast Kompania Rajon Ujësjiellësit Hidromorava SH.A , me datë 12.07.2023, ka iniciuar tenderin me titull: Furnizim me kimikate (klor të gazet dhe të lëngët) dhe Permanganat Kaliumi, me ç 'rast ne si OE te interesuar kemi marr pjese dhe kemi dorëzuar ofertën tonë më të mirë brenda afateve kohore të parashikuara me Njoftimin për Kontrate. 1 2. Autoriteti Kontraktues, me datë 25.08.2023 15:15, kishte shpërblyer me kontratë kompaninë tonë Seykos Sh.p.k si OE i përgjegjshëm me çmimin me te lirë. 1 3. Ndërkaq pas kësaj date GOE Infinit Sh.P.K; Lighthouse; Elogistics L.L.C, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe me pas ankese ne OSHP, vendimi pas të cilit kishte kthyer lëndën në Ri-Vlerësim. 1 4. Autoriteti Kontraktues, duke vepruar ne kundërshtim me LPP-ne, RRPP 001.2022 dhe Vendimin e OSHP-ës të datës 20.10.2023, ka rivlerësuar ofertat dhe me date 21.11.2023, dhe ka shpërblyer me kontratë një GOE i cili është i pa përgjegjshëm teknikisht, administrativisht dhe profesionalisht. Për më tepër, AK gjatë Rivlerësimit të ofertave nuk ka marr për bazë vendimin e PSH OSHP nr. 2023/0662, që konform Nenit 72 të LPP-ës dhe nenit 38 të Rregullores 01/2022 të kërkoj sqarime shtese tek ne si OE. 1 5. Këtë veprim e ka ndërmarr me datë 04.12.2023, vetëm pas dërgimit të Kërkesës për Rishqyrtim nga ana e jonë pranë AK, ku te njëjtit përmes emailit dhe sistemit elektronik te tenderëve kanë dërguar letrën standarde e

kërkesës për sqarimin e tenderit. 1 6. Me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës me datë 21.11.2023, AK fillimisht ka shkelur Nenin 60 Kriteret për dhënien e kontratës, pasi që kanë rekomanduar për kontratë një GOE të cilët nuk kanë çmimin me të lire konkurrues, dhe se dyti |GOE i rekomanduar është i pa përgjegjshëm sipas kërkesave të dosjes së tenderit. 1 7. Në si OE me interes për këtë tender, kemi dorëzuar një ofertë të përgjegjshme në çdo kërkesë të dosjes së tenderit në vlerësimin e parë, njëjtë do të duhej të trajtohem edhe në rivlerësim nga AK, dhe në rast se për AK do të kishte nevojë për informata plotësuese për sqarimin e ndonjë kërkesë apo dokumenti i cili nuk është kërkuar në DT, atëherë sipas LPP-se neni 72 dhe sipas mendimit të Ekspertit dhe panelit shqyrtues do të duhej të na kërkonte informacione shtese, sepse në si OE i kemi plotësuar dhe dorëzuar Deklaratën e përmbushjes së specifikave teknike për mallrat e ofruara, e cila është pjesë dhe kërkesë e Dosjes së tenderit respektivisht FTD-se. 1 8. Autoriteti Kontraktues, ka eliminuar OE Seykos Sh.p.k me arsyetimin, po citojmë; Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë ka qenë kërkesa që Operatorit Ekonomik (Tenderuesi), me tenderin e tij, duhet të dorëzojë dokumentacion të skanuar se prodhuesit, përmes të cilit mund të verifikohen të dhënat teknike të materialeve të kërkuara ofruara në këtë tender dhe të dëshmohet me katalogje, manuale apo broshura të materialeve të përgatitura nga prodhuesi, të skanuara. Operatori Ekonomik Seykos Sh.P.K nuk ka ofruar specifikacion teknik për pozicionin nr.3 të paramasës Pemanganat Kalium, në nenin 10 thuhet se kur mungon specifikacioni teknik dhe katalogjet për produktet e ofruara atëherë tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacion shtese. Duke ju referuar të gjitha ato që u thane më lartë, komisioni i vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave ju konsideron të përgjegjshëm.”

*Pretendimi i dytë (II):* “Autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar kurrfarë parametri për produktin 3 për të cilin ka konstatuar se nuk është ofruar sipas dosjes së tenderit 2.1. AK për produktin nr. 3 as në Njoftimin për Kontratë dhe as në Dosjen e Tenderit nuk ka ofruar dhe nuk ka kërkuar asnjë specifikim teknik apo detaj tjetër për këtë produkt, siç kishte vepruar me 2 produktet e para ku ka ofruar Specifikim Teknik dhe detaje të tjera për të cilat në si OE të cilët ishim shpërblyer me kontratë në vlerësimin e parë i kemi dorëzuar së bashku me dosjen e tenderit. Prandaj, për produktin nr. 3, në kemi dorëzuar vetëm ofertën tone financiare. 2.2. Ndërsa AK ka përdorur si pretekst mungesën e të dhënave teknike për këtë produkt për të eliminuar ofertën tone. Prandaj veprimi i AK bie ndesh me Rregulloren nr. 01/2022: - neni 25.5 ku specifikohet “Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzojë në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar”, - Neni 40.2 ku specifikohet “Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do të jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar” dhe - Nenin 40.12 ku sqarohet ”Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. 2.3. Prandaj, AK nuk mundet që të eliminojë ofertën tone duke u bazuar në kërkesa të pa specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit. Përveç kësaj, në si OE kemi dorëzuar “Deklaratën e përmbushjes së specifikave teknike në përputhje me kërkesën e AK” çka do të thotë se AK ka pas baze të mjaftueshme për vlerësimin e ofertës tone, si dhe baze

te mjaftueshëm ligjore, nëse do ta kishte parë të arsyeshme, për të kërkuar informacion plotësues për produktin nr. 3 ekzistenca e të cilës është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. 2.4. Ne si OE pjesëmarrës dhe me interes, me datë 21.11.2023, pas pranimit të njoftimit mbi vendimin e AK, konform Nenit 10 të LPP-se, kemi kërkuar qasje në dokumentet e GOE të shpërblyer me kontratë, me ç' rast AK gjatë dhënies së qasjes ka vepruar në kundërshtim me këtë Nen, pasi që nuk na ka dhënë qasje të plote dhe nuk na ka siguruar dokumentacionin e kërkuar përveç atij të klasifikuar si Sekret Afarist – Konfidencial. Provë kërkesa për qasje në dokumente dhe dokumentet e kërkuara. Në përgjigje të këtyre kërkesave ne kemi pranuar email të cilin e kemi bashkangjitur në ankese. 2.5. Siç mund të shihet, përveç njoftimit mbi vendimin e AK, në sistemin elektronik ne nuk mund të shohim asnjë nga dokumentet e tjera të kërkuara nga AK, dhe duke e parë neglizhencën e AK për të ofruar këto dokumente, ne si OE me interes për këtë aktivitet të prokurimit, duke shfrytëzuar të drejtën tonë për dokumentet të cilat nuk konsiderohen sekrete afariste kemi dërguar kërkesën edhe përmes sistemit elektronik të tenderëve të cilën AK e ka hapur dhe nuk ka kthyer asnjë përgjigje. 2.6. Ne si OE gjatë qasjes në Dokumente, me USB kemi pranuar vetëm një pjesë të dokumentacioneve të dhëna nga AK, ne kemi bashkangjitur në ankese një screenshot. 2.7. Nga analizimi i dokumenteve, kemi vërejtur se AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 69 të LPP-se dhe Nenin 28. Kërkesa Nr.5 e DT. Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me tenderin e tij, duhet të dorëzojë dokumentacion të skanuar se prodhuesit, përmes të cilit mund të verifikohen të dhënat teknike të materialeve të kërkuara ofruara në këtë tender; - Dëshmia për kërkesën Nr.5. Kataloge, manuale apo broshura të materialeve të përgatitura nga prodhuesi, të skanuara. 2.8. Dokumentacionet e ofruara nga GOE i rekomanduar për kontrate për këtë pike janë në kundërshtim dhe me specifikimin teknik, pasi që nuk përmbushin kërkesat e AK. Ne DT, respektivisht Specifikimi Teknik i detyruar, AK ka kërkuar: (citoj) Aneksi 1- Specifikimet Teknike Të Detyrueshme 1.Klori gaz Cl<sub>2</sub>.....99,8% CO<sub>2</sub>.....0,1% Lagështia 367 ppm 2.9. Siç shihet, Pastërtia e klorit ose klori aktiv është kërkuar të jete 99.8% Cl<sub>2</sub>. Ndërkaq GOE i rekomanduar ka ofruar tek katalogu me specifikime teknike, për Gas Klor; Specifikat teknike të vulosura dhe nënshkruara nga prodhuesi me klorin aktiv: Chlorine content: min 99,5% v/v, e cila është në kundërshtim me kërkesën e DT dhe specifikimit teknik. 2.10. Po ashtu edhe SAFETY DATA SHET i ofertuar nga GOE i rekomanduar është e dyshimtë në përmbajtjen e saj dhe e njëjta nuk përputhet me SAFETY DATA SHET e cila mund të shkarkohet në web faqen e prodhuesit

ne  
linkun:[https://www.vinyl.hu/en/Chemical\\_products\\_and\\_solutions/Chlorine\\_gas.html](https://www.vinyl.hu/en/Chemical_products_and_solutions/Chlorine_gas.html)

3.Hipklorit Natriumi (klor i lëngët) AK për këtë produkt kishte kërkuar: Përmbajtja e disponueshme e klorit....14% minimum në peshë Graviteti specifik në 25°C.....1.170 minimum Total alkalid si NaOH...1.2% minimum në peshë Përmbajtja maksimale e Bromateve (BrO<sub>3</sub>-)....0.035% në peshë Përmbajtja maksimale e klorateve (ClO<sub>3</sub>-).....0.25% në peshë 2.11. Pra edhe këtu siç mund të vëreni, AK ka kërkuar që klori aktiv të jete minimum 14%. Ndërkaq GOE i rekomanduar për kontrate ka ofruar dokumente si me poshtë; Safety Data Sheet Sodium Hypochlorite Solution 12.5% active chlorine 2.12. Dhe SPECIFICATION Sodium hypochlorite 150 g/l të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e AK, dosjes së tenderit dhe Specifikimit teknik! Duke sjell në kujtesë se produktet në fjalë përdoren për pastrimin dhe përgatitjen e ujit të pijshëm për regjionin e anamoravës, ku janë të përfshira se paku 3 komuna, veprim ky që lidhet direkt me shëndetin dhe sigurinë e banoreve të këtyre zonave, AK do të duhej të ishte shumë i saktë dhe rigoroz sa i përket plotësimit të specifikimeve teknike për produktet e kërkuar.”

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 7, 10, 59, 60, 69, 72 të LPP-së dhe RRPP 001.2022. Duke propozuar që OSHP të Aprovoj, si të bazuar ankesën e OE “Seykos” Sh.P.K.



dhe të Anulohet, njoftimi dhe vendimi i AK-së datë 21.11.2023 dhe lënda të kthehet në Rivlerësim

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave* –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 18.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1016/23, ndërsa me datë 28.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1016 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK, për dhënie kontrate i dt. 21.11.2023.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrës dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

*Lidhur me pretendimet e OE “Seykos SH.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1016 ka vlerësuar si në vijim:*

*Konstatimi i parë (I):* “Struktura e ankesës e përgatitur nga operatori ekonomik ankues nuk është e ndarë në pretendime ankimor mirëpo për qëllime praktike të raportit të ekspertizës i kemi renditur pretendimet ankimore si në vijim. Pretendimi ankimor nr. 1, i operatorit ekonomik ankues ka të bëjë me eliminimin e operatorit ekonomik ankues gjatë procesit të rivlerësimit si operator i pa përgjegjshëm me arsyetimin se nuk ka ofruar katalog dhe specifikime teknike për produktin nr. 3, të paramases Permanganant Kaliumi. Ky pretendim ankimor është trajtuar edhe në Vendimin e P.SH të datës 06.09.2023 nr 2023/0662, ku paneli shqyrtues kërkon nga AK-Kompania Rajonale e Ujësjesit Hidromorava Sh.A të bëjë një verifikim të dy katalogjeve tjera të ofruara për dy pozicionet nëse eventualisht ka specifikim teknik për poz. nr. 3 të Paramases Permanganant Kaliumi, nëse po të kërkohej informacione shtesë, nëse jo të refuzohet tenderi pa kërkuar informacion shtesë. AK-Kompania Rajonale e Ujësjesit Hidromorav Sh.A gjatë fazës së rivlerësimit dhe përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar me dt. 21.11.2023 ka shpallur si të pa përgjegjshëm operatorin ekonomik ankues me arsyetimin si në vijim: Organi Ekonomik Seykos Sh.P.K nuk ka ofruar specifikacion teknik për pozicionin në paramases Permanganat Kalium, në nenin 10 thuhet se kur mungon specifikacioni teknik dhe katalogjet për produktet e ofruara atëherë tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacion. Në bazë të sqarimeve të mësipërme AK-Kompania Rajonale e Ujësjesit Hidromorava Sh.A, raportit të rivlerësimit, letrës standarde për tenderuesin e eliminuar AK gjatë fazës së rivlerësimit nuk ka hasur në specifikacione teknike tek katalogjet e ofruara nga operatori ekonomik ankues për produktin në pozicionin nr. 3. Në këtë mënyrë pretendimi i operatorit ekonomik ankues që AK ka shkelur nenin 72 të LPP-se dhe nuk ka marrë për bazë Vendimin e PSH nr. 2023/0662 sa i përket këtij pretendimi ankimor nuk qëndron sepse paneli shqyrtues përmes vendimit nr. 2023/0662 në mënyrë të çartë ka konstatuar se “nëse eventualisht ka specifikacion teknik për pozicionin nr.3 të paramasës Permanganat Kalium, nëse po, atëherë të kërkohej informacione shtesë, nëse jo të refuzohet tenderi pa kërkuar informacion shtesë”. AK në këtë rast ka vepruar sipas vendimit të panelit shqyrtues nr. 2023/0662 në lidhje me këtë pretendim ankimor. Bazuar në sqarimet e mësipërme, shkresat e lendes, raportit të rivlerësimit, vendimit të PSH nr 2023/0662 të dt.06.09.2023 konstatojmë se ky pretendim ankimor është i pa Bazuar.”

*Konstatimi i dytë (II):* “Pretendimi ankimor nr. 2, ka të bëjë me faktin se Operatorit Ekonomik ankues nuk i është lejuar qasja në dokumentet e tenderit sipas nenit 10 të LPP-së. Operatori ekonomik ankues me dt. 21.11.2023 pas pranimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-se ka kërkuar qasje në dokumentet e tenderit të GOE të shpërblyer me kontratë, mirëpo sipas Operatorit

Ekonomi Ankues ju është lejuar qasje e kufizuar dhe jo e plotë duke mos ju siguruar tërë dokumentacionin e kërkuar. Theksojmë se sipas nenit 10 të LPP-së saktësisht paragrafit 3 të këtij neni, citat neni: “Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3 të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënie në kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar paradhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datë në njoftimit për anulim sipas paragrafit 2 të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.” Konstatohet se disa nga kërkesat për qasje në dokumente janë të publikuara edhe në web faqen e E-prokurimit tek ky aktivitet i prokurimit. Bazuar në paragrafin e mësipërm sipas LPP-së rekomandojmë AK-Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidromorav Sh.A se qasja në dokumentet e tenderit duhet të lejohet në harmoni të plotë me paragrafin 3 të nenit 10 të LPP-së Mjetet për promovimin e Transparencës. Nga shkresat e lëndës rezulton se disa nga dokumentet e kërkuara nga operatori ekonomik ankues përmes emailit të dt. 23.11.2023 nuk janë në listën e dokumenteve të përfshira nga GEO të rekomanduara për kontratë sipas Aneksit 3 Kërkesa për konfidencialitetin e dt. 24.07.2023. Bazuar në sqarimet e mësipërme, shkresat e lëndës, raportit të rivlerësimit, aneksit 3 Kërkesës për Konfidencialitet, konstatohet se ky pretendim ankimor është i pjesërisht i bazuar.

*Komisioni i tretë (III):* “Sipas operatori ekonomik ankues oferta e rekomanduar për dhënie të kontratës pas rivlerësimit të ofertave nuk i plotëson disa nga specifikimet teknike të kërkuara nga AK-Kompania Rajonale e Ujësjetës Hidromorava Sh.A në dosje të tenderit siç janë Klori Gaz, C12 .....99.8% dhe tek Hipoklorit Natriumi klori aktiv 14% minimum në peshë. - Në bazë të katalogut të prodhuesit të ofruar nga GOE të rekomanduar për kontratë shihet se është cekur Chlorine content: min 99.5% dhe nuk nënkupton që nuk mund të arrihet vlera 99.8% siç është kërkuar në dosje të tenderit nga autoriteti kontraktues sepse është ofruar vlera minimale. Po ashtu nga katalogu i prodhuesit shihet se shkruan se Produkti është sipas standardit EN 937 - Kimikate që përdoren për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor- Klor. Citat nga katalogu i prodhuesit: “The product is according to the EN Standard 937- Chemicals used for treatment of water intended for human consumption-Chlorine.” Sa i përket përmbajtjes së disponueshme të klorit ku është kërkuar 14 % minimum në peshë shihet se nga katalogu i prodhuesit saktësisht në fq. 6 tek pika 9.1 e katalogut të prodhuesit rezulton se përmbajtja e disponueshme e klorit është ofruar me 12.5 +/- 2.5 pra në këtë mënyrë vlera e ofruar në +/- rezulton të jetë brenda parametrave të kërkuara nga autoriteti kontraktues në dosjen të tenderit. Konstatohet se mbetet në përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues se gjatë ekzekutimit të kontratës të bëjë mbikëqyrjen e vazhdueshme të furnizimeve nëse janë duke u plotësuar parametrat e kërkuara nga autoriteti kontraktues sipas specifikimeve teknike në dosje të tenderit dhe furnizimet të bëhen në harmoni me vlerat e kërkuara në dosje të tenderit. Bazuar në sqarimet e mësipërme, shkresat e lëndës, raportit të rivlerësimit nga AK, specifikimeve teknike të dosjes së tenderit, ofertën e GOE të rekomanduar për dhënie kontratë konstatohet se ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Bazuar në përshkrimin e bërë me sipër sipas shkresave të lëndës, raportit të ri vlerësimit, dosjes së tenderit, Vendimit të panelit shqyrtues nr. 2023/0662 të datës 06.09.2023, eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 21.11.2023 për dhënie kontrate.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu edhe OE Nuk pajtohet

me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot lidhur me rastin.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertes shqyrtuese. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertëve shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, ka kërkuar nga ekspertët që për këto konstatime të ofrohen elaborime dhe shpjegime të mëtutjeshme me qëllim të vendimmarrjes meritore sepse kemi të bëjmë me një natyrë të ndjeshme dhe me shëndetin publik të qytetarëve. Kështu që, ekspertët kanë ofruar shpjegimet e tyre me dt. 29.12.2023 ku kanë qëndruar mbrapa arsytimi se pretendimet ankimore janë të pabazuara dhe kanë ofruar shpjegime për të cilat paneli shqyrtues ia fal besimin.

Andaj, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, aq më tepër në rast se ankuesi rezulton të jetë i papërgjegjshëm, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me

kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Interlab SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: